



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 30.03.2015, ora 10:10

Drejton mbledhjen:

Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.03.2015.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi” të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim, Agjencia zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW” për fondet IPA të Bashkimit Europian për furnizimin me ujë të zonave rurale III”.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi” të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim “Agjencia zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW”, për masat shoqëruese për furnizimin me ujë të zonave rurale III”.

Marrin pjesë:

Majlinda Bregu, Taulant Balla, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi, Bujar Derveni, Gerti Bogdani.

Mungojnë:

Arben Imami, Edi Paloka, Esmeralda Shkja, Gramoz Ruçi, Kejdi Mehmetaj

Të ftuar:

Erjon Luçi – zëvendësministër i Financave

HAPET MBLEDHJA

Majlinda Bregu – Përshëndetje!

Hapim mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës të mbledhjes së ditës së sotme kemi:

Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 25.03.2015.

Shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi” të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim, Agjencia zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW” për fondet IPA të Bashkimit Europian për furnizimin me ujë të zonave rurale III”;

shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi” të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim “Agjencia zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW”, për masat shoqëruese për furnizimin me ujë të zonave rurale III” dhe të tjera.

Mirëdita, zoti Zëvendësministër i Financave! Me sa kuptova duhet të ishte në komision dhe zëvendësministri i Transportit. Ka përfaqësues nga Ministria e Transportit? Nuk ka.

Ka përfaqësues nga Ministria e Integritit? Megjithëse nuk ka kaluar tek ta për mendim. As te Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend.

Zoti Zëvendësministër, mund të na flisni fare shkurt për të dyja marrëveshjet, pavarësisht se duhet të kenë kaluar dhe fazat e tjera në komision dhe nuk besoj se do të ketë ndonjë ndryshim termash, për sa kohë që kjo marrëveshje qenka pjesë e programimit të IPA-s 2008, para 5 vjetësh, dhe është faza e tretë. Nëse ka ndonjë gjë të re për fazën e tretë të kësaj marrëveshjeje? Po.

Erjon Luçi – Siç është paraqitur në relacion, faza e tretë ka si qëllim kryesor rehabilitimin më shumë sesa ndërtimin e ujësjellësve të rinj, pa pasur objektiva fazat e para. Kështu që kjo është në vazhdim të të njëjtit projekt që ka KfW-ja në sektorin e ujit. Janë projekte që deri tani kanë ecur mirë. Si termo janë po aq të mira që të mira, kështu

që është një projekt që ne e kemi mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga qeveria dhe jemi goxha mirënjohës dhe KfW-së për këtë përfshirje në këtë sektor kaq të rëndësishëm. Për ndonjë specifikë pastaj mund të sqarohemi.

Dhe në fund fare janë dhe aktivitetet që do të ndërmerren, por që janë akoma në fazën e përzgjedhjes dhe të zonave të cilat do të rehabilitohen dhe më pas do të jetë disbursimi i fondeve të akorduara sipas studimit paraprak që do të bëhen me një grant të Western Balkan Investment Found që i ka përfshirë. Por që është në frymë shumë i ngjashëm me fazën e parë dhe fazën e dytë që janë projekte goxha të domosdoshme dhe të suksesshme deri tani.

Majlinda Bregu – Për Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend të dyja projektligjet besoj se të dyja janë në përputhje me *Acquie*-n e Bashkimit European në fushën për të cilën projektligji ka veprim, me legjislacionin parësor të Bashkimit European, me atë dytësorin, me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit i cili parashikon zhvillimin e rajoneve dhe zhvillimin lokal, pra, si përfundim në përputhje me të gjitha dispozitat e *Acqui*-s për të reduktuar pabarazinë dhe për t'i dhënë mundësi zhvillimit ekonomik dhe social të rajoneve në përputhje me standardet e BE-së, projekt i cili ka nisur në vitin 2008. Ka pyetje?

Gerti Bogdani – Kam vetëm një pyetje, por më shumë e kam për korrigjim. Neni 1/1 thotë: "KfW-ja i jep marrësit një kontribut financiar që nuk i kalon" dhe shifra këtu është 150 milionë euro. Kam përshtypjen që është lapsus.

Majlinda Bregu – Cili projektligj? I pari apo i dyti?

Gerti Bogdani – Tek i dyti duhet të jetë.

Majlinda Bregu – Po sheh marrëveshjen e financimit që thotë: "Jemi marrësi për kontribut financiar që nuk e tejkalon shumën?"

Gerti Bogdani -Ka shumë zero.

Majlinda Bregu – 9 milionë e ...

Gerti Bogdani – Jo, jo më tutje.

Majlinda Bregu – Është projektligji i dytë. Neni 1 është projektligji i dytë.

Majlinda Bregu – 1 milion e 500 mijë euro.

Gerti Bogdani – Te neni 1 e keni 150 milionë euro.

Majlinda Bregu – Në qoftë se ka ndonjë gabim kompjuterik, se Ministria e Financave nuk të fal ndonjë zero më shumë, harroje. E shumta mund të heqë ndonjë zero, jo t’i japë ndonjë zero më tepër.

(Diskutime pa mikrofon)

Majlinda Bregu - Mos i ka ministri nga fondi i vet për t’ia shtuar kësaj marrëveshjeje këto? E kemi të qartë, sepse në përgjithësi projektet e IPA-s, ose jo, rrallë kanë ngelur peng dhe i konfliktit mes pushtetit lokal dhe pushtetit qendror. Të paktën kështu ka qenë për një kohë të gjatë. Në qoftë se nuk ka ndonjë pyetje tjetër, jeni dakord?

Faleminderit!

Kemi një vendim për datën 07.04.2015, për të kaluar me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit IPA II”.

Projektligji është aktualisht në komisionet e tjera. Ka kaluar në Komisionin e Ligjeve dhe ne jemi komisioni përgjegjës. Prandaj në datën 7 prill do t’ju lutesha të mos mungonit.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA